



Republika e Malit të Zi  
Qeveria e Republikës së Malit të Zi

---

**Plani i aksionit**  
**Integrimi i zhvillimit të qëndrueshëm**  
**në sistemin e arsimit**  
**për periudhën 2007-2009**

PODGORICË

2007



Këtë plan të aksionit e kanë përgatitur *Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Enti për Shkollim, Qendra për Arsimim Profesional, Qendra e Provimeve dhe Enti për Tekste dhe Mjete Mësimore*, me përkrahjen e **Fondacionit** Instituti për shoqëri të hapur, përfaqësia në Mal të Zi.

## **P Ë R M B A J T J E**

1.	Hyrje.....	5
2. 2	Bashkëpunimi me grupet e destinimit dhe informimi i opinionit .....	9
2. 3	Monitorimi dhe evaluimi i aplikimit të Reformës.....	11
3. 4	Përsosja profesionale dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional .....	12
3. 5	Integrimi i ICT në procesin e arsimit .....	15
3. 6	Inkluzioni.....	16
3. 7	Arsimimi i pakicave.....	18
3.7.1.	Arsimimi në gjuhën amtare shqipe .....	18
3.7.2	Arsimimi i romëve .....	20
3. 8	Tekstet, doracakët dhe mjetet e tjera mësimore.....	23
4. 1. 1	Edukimi dhe arsimimi parashkollor/ programi i arsimit .....	25
4. 2. 1	Arsimimi fillor/ programi i arsimit .....	26
4. 3. 1	Gjimnazet/shkollat e mesme/ programi i arsimit.....	30
4. 4. 1	Arsimimi profesional/ programi i arsimit dhe standardet e profesioneve .....	34
4. 5. 1	Arsimimi i të rriturve/ programi i arsimit .....	36
5.	Pasqyra e buxhetit të përgjithshëm .....	38
	Përfundim.....	39



# 1. HYRJE

Qëllimi i punimit të *Planit të aksionit* është krijimi i kushteve për futjen me plan të përmbajtjeve të zhvillimit të qëndrueshëm në sistemin tonë arsimor. Në kuadër të këtij plani të aksionit është bërë planifikimi, definimi dhe lidhja e aktiviteteve të institucioneve të arsimit për implementimin e zhvillimit të mundshëm në sistemin e arsimit në periudhën e ardhshme trevjeçare. Me të definohen detyrat, roli, dinamika dhe mjetet e nevojshme financiare për institucionet e arsimit, përgjegjëse për realizimin e aktiviteteve të parapara. *Plani i aksionit* është akorduar me parimet dhe qëllimet e Strategjisë së KB, me Strategjinë nacionale (shtetërore) të zhvillimit të qëndrueshëm dhe me dokumentet kyçe për aplikimin e Reformës së arsimit. Për shkak të rëndësisë që arsimit për zhvillim të qëndrueshëm ka në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, Plani i aksionit do të radhitet si aneksi i **Planit strategjik të Reformës së arsimit për periudhën e viteve 2005-2009**, me të cilin parashikohet arritja e qëllimeve afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata në periudhën e ardhshme. Gjatë implementimit do të kihet kujdes për parimet të cilat janë të përfshira në konventat ndërkombëtare dhe deklaratat nga fusha e arsimit.

Në kohën e ndryshimeve të shpejta të shoqërisë është me rëndësi që të zhvillohet vetëdija mbi rëndësinë e konceptit të zhvillimit të mundshëm në të gjitha nivelet e arsimit. Kombet e Bashkuara e kanë shpallur dekadën 2005-2014, dekadë të arsimit për zhvillim të qëndrueshëm, kurse Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) ka miratuar Strategjinë **për futjen e zhvillimit të qëndrueshëm në sistemin e arsimit** në mbledhjen e ministrave të arsimit dhe mjedisit jetësor në Vilnius me 17-18 mars 2005. Te ne, gjatë punimit të **Strategjisë nacionale (shtetërore) të zhvillimit të qëndrueshëm të Malit të Zi**, sektori i arsimit është dalluar përmes dy qëllimeve me përparësi:

- **Arritja e arsimit cilësor për të gjithë fëmijët; arritja e qëllimeve zhvillimore të Mileniumit dhe qëllimeve të Planit nacional (shtetëror) të aksionit për fëmijët.**
- **Rritja e përmbajtjeve tematike të zhvillimit të qëndrueshëm në programet e arsimit nga niveli parashkollor deri tek ai universitar.**

Sistemi i arsimit në Mal të Zi në disa vite të fundit, në mënyrë sistematike ndryshon, gjë që paraqet një rën nga përgjigjet ndaj realitetit shoqëror i cili kërkon ndryshime në arsim, përshtatjen e tij dhe bashkëpunim me vendet e tjera në regjon e më gjerë. Njëri nga qëllimet e rëndësishme të Reformës së arsimit në Mal të Zi që vijon është që përmes sistemit të rregullt të arsimit fillor dhe të mesëm të ndërtohet personaliteti i nxënësit/es i/e cili/a do t'i respektojë dhe në të ardhmen do t'i marrë në konsideratë, do t'i kuptojë dhe do t'i implementojë parimet themelore dhe konceptin e miratuar të zhvillimit të mundshëm në Mal të Zi.

Programet e reja, të punuara, arsimore, të shkollave fillore, të shkollave të mesme profesionale dhe gjimnazeve, nëkuptojnë arritje të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave të drejtuara kah arritja i qëllimeve të rëndësishme ekonomike, sociale dhe ekologjike.

Implementimi i planeve të reja rrjedh në përputhje me dinamikën e Planit të Reformës dhe gjer tani ka përfshirë numrin më të madh të shkollave fillore dhe të mesme. Në vitin shkollor 2004/05 në Reformë janë përfshirë 20 shkolla filllore (shkollat e grupit A), në vitin shkollor 2005/06 – 27 (shkollat e grupit B), në vitin shkollor 2006/07 -28 (shkollat e grupit C), kurse në vitin shkollor në Reformë do të përfshihen 44 shkolla fillore. Gjer në fund të vitit 2013/14, është planifikuar që të gjithë nxënësit, nga klasa e I-IX të përfshihen në programet e reja të reformuara.

Me aktivitetet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, shkollave, shoqatës së prindërve dhe bashkisë lokale, për sigurimin e kushteve për realizimin e programit të ri të arsimit të shkollës fillore, me kohëzgjatje prej 9 vitesh do të arrihet ngritja e shkollës së regjistrimit të fëmijëve nga 96.9% në vitin 2002, në 97,6% për vitin 2005, gjer në 99% mbyllur me vitin 2015, siç është planifikuar me qëllimet zhvillimore të Mileniumit dhe Planit nacional (shtetëror) të aksionit për fëmijë.

Vitin shkollor 2006/07, të gjitha gjimnazet (22) e kanë filluar me implementimin e programeve të reja të arsimit. Sipas programeve të reja të arsimit janë hequr drejtimet, kurse drejtimi i fëmijëve lidhet me zgjedhjen e lëndëve zgjedhëse. Matura e parë eksterne do të realizohet në vitin shkollor 2009/10 në organizim të Qendrës së Provimeve të Malit të Zi.

Në vitin shkollor 2007/08 në Reformë do të përfshihen 119 shkolla fillore dhe paralelet e klasës së parë dhe të dytë të gjimnazeve në Mal të Zi. Në vitin 2007, në 47 shkolla fillore të cilat i aplikojnë programet e reja arsimore do të zbatohet pilot testimi i nxënësve/eve të klasës së 3-të nga matematika dhe gjuha amtare, kurse për nxënësit/et e klasës së 6-të, nga matematika, gjuha amtare dhe gjuha e huaj. Qendra e Provimeve krahas provimeve eksterne organizon dhe zbaton edhe maturën eksterne në gjimnaze në Mal të Zi. Programet e reja arsimore realizohen në 26 shkolla të mesme profesionale.

Arsimi është faktor i pashmangshëm dhe parakusht i ngritjes ekonomike, sociale, ekologjike dhe vizionit kulturor dhe etik të zhvillimit të qëndrueshëm të Malit të Zi. Përparimi i shoqërisë në të ardhmen duhet të mbështetet në njohurinë e cila i respekton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.

Reforma e sistemit të arsimit duhet ta pasurojë nivelin arsimor të popullatës, me vetëdije të qartë për rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm në procesin e integritimeve evropiane. Zbatohet në mënyrë graduale, sistematike dhe gjithëpërfshirëse.

**Programet e arsimit** janë modernizuar dhe u janë përshtatur kërkesave bashkëkohore nga ajo lëmi në Evropë. Janë punuar në funksion të planifikimit të lëndës mësimore sipas qëllimeve, kurse arsimtarët/et i zgjedhin metodat dhe aktivitetet me të cilat, në mënyrën më të suksesshme, do t'i realizojnë qëllimet. Programet e reja të lëndëve janë të hapura – rreth 20% të përmbajtjeve mund t'i krijojnë vetë arsimtarët/et, nxënësit/et dhe shkolla në bashkëpunim me bashkinë lokale. Përmbajtjet e zhvillimit të qëndrueshëm në programet e lëndëve janë të përfaqësuar në përqindje të lartë.

Janë futur **lëndët zgjedhëse të obligueshme** në shkolla fillore, në gjimnaze dhe në shkolla profesionale. Nxënësve/eve u është mundësuar që vetë të zgjedhin numër të caktuar të lëndëve përmes të cilave më mirë do të mund ta shprehin krijimtarinë e vet dhe t'i kënaqin interesimet e veta.

Kur është në pyetje gjimnazi i përgjithshëm, nxënësit/et përmes **lëndëve zgjedhëse të obligueshme** në mënyrë të veçantë e krijojnë "drejtimin" e vet dhe ashtu në mënyrë aktive ndikojnë në formimin e orientimit të vet profesional. Arsimtarët/et përmes lëndëve zgjedhëse të obligueshme e afirmojnë fushën për të cilën janë aftësuar profesionalisht.

Në arsimin profesional katërvjeçar mësimi zgjedhës përcaktohet me programin e arsimit dhe në këtë mënyrë nxënësve/eve u ofron zgjedhjen e lëndëve që japin arsimin e përgjithshëm ose njohuri specifike ose më të plotë profesionale. Te arsimimi profesional trevjeçar vëmendje e veçantë është kushtuar mësimin praktik për të cilin është paraparë fond i caktuar orësh, përmes të cilave nxënësi/ja arrin njohuri dhe shkathtësi të nevojshme praktike, të domosdoshme për kryerjen e punëve të caktuara. Arsimi profesional trevjeçar realizohet përmes formës shkollore apo duale të arsimit.

Duke qenë se në botë që moti është vërejtur nevoja e mësimin dhe arsimit të vazhdueshëm, e me qëllim të vendosjes së sistemit të arsimit, i cili garanton zhvillim të përgjithshëm ekonomik dhe shoqëror, rëndësi e veçantë i është kushtuar arsimimit të personave të rritur përmes futjes dhe zhvillimit të programeve të reja të arsimit të rriturve.

Me qëllim të rritjes së **përmbajtjeve tematike dhe zhvillimit të qëndrueshëm në programet e arsimit**, në Entin për Shkollim dhe Qendrën për Arsimim Profesional është bërë një pasqyrë (analizë e hollësishme) e programeve të reformuara të lëndëve, nga arsimimi parashkollor deri tek ai universitar. **Përmbajtjet e zhvillimit të qëndrueshëm** janë të shfaqura përmes qëllimeve operative në temën e dhënë, aktiviteteve që e përcjellin temën e mësimin, dhe janë dhënë edhe nocionet të cilat përpunohen përmes temave gjegjëse. Në fund të analizës së secilit program të lëndës është bërë vlerësimi i përmbajtjeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm.

Hapi vijues është punimi i programeve për shkollat fillore, gjimnazet dhe shkollat e mesme profesionale që mund të ofrohen në kuadër të lëndës së veçantë zgjedhëse, mësimin praktik, ose në kuadër të përmbajtjeve në programet ekzistuese të lëndëve nga niveli parashkollor deri tek ai universitar.

Që nxënësit/et të aftësohen për zhvillimin e qëndrueshëm dhe aftësive të domosdoshme për të kuptuar dhe respektuar lidhjen e ndërsjellë ndërmjet të njeriut dhe mjedisit dhe kuptimin e esencës së gjithëmbarshme, nocionit të procesit ose problemit, duhet një qasje multidisiplinare në mësim, gjë që kërkon ndërlidhje të mirë në mes lëndëve.

Me planin e shkollës fillore nëntëvjeçare në kuadër të aktiviteteve të obligueshme, janë të parapara dhjetë ditë për kulturë, sport, teknikë dhe shkollë në natyrë. Kjo ka të bëjë me mundësinë e organizimit të mësimin jashtë mësonjëtores në ambientin e natyrës, ose në institucione siç janë muzetë, galeritë, arkivat dhe bibliotekat. Koncepti i projektit të shkollës në natyrë duhet t'u mundësojë nxënësve/eve që të njihen me thesarin kulturor-historik dhe bukuritë natyrore të vendit të vet në mënyrë të vazhdueshme, cilësore dhe interesante.

Realizimi i programit nuk mund të arrihet në mënyrë cilësore pa **arsimtarë/e të trajnuar/a dhe mjete gjegjëse mësimore**. Paraprakisht është e domosdoshme të zhvillohet programi i trajnimit për arsimtarët/et të cilët/at e realizojnë mësimin sipas programeve të reja të arsimit, të bëhet aftësimi i trajnerëve, të bëhen pilot projekte të vogla ku me një grup të vogël arsimtarësh/esh do provohet modeli i trajnimit, e pastaj në pajtim me aktivitetet e parapara me *Planin e Aksionit* të fillohet me trajnimin e arsimtarëve/eve.

*Enti për Shkollim* dhe Qendra për Arsimit Profesional e organizojnë trajnimin e arsimtarëve/eve për realizimin e programeve të reja të arsimit, kurse Qendra e Provimeve e organizon trajnimin për autorët e testeve dhe administratën e provimeve-testeve.

Një numër i konsiderueshëm orësh në kuadër të programit të trajnimit i është kushtuar prezantimit të programeve të reja. Domethënë, programet e reja të lëndëve dallojnë dukshëm nga të përparshmit. Gjersa programet e vjetra kanë rekomanduar përmbajtjet të cilat fëmijët duhet t'i mësojnë, programet e reja parashtrajnë qëllimet të cilat duhet të arrihen. Gjithashtu propozojnë aktivitetet e caktuara të cilat mundësojnë të fituarit aktiv të njohurive, që është parakusht që njohuritë e arritura të jenë të aplikueshme cilësore dhe të qëndrueshme.

Me përfundimin e këtij trajnimi, arsimtarët/et aftësohen që, gjatë realizimit të mësimin t'i aplikojnë metodat dhe format e reja të punës, kurse problematika e qëndrueshmërisë lihet menjandë.

Trajnerëve që i udhëheqin seminarët u mungon përfytyrimi i qartë se në cilën mënyrë t'u ofrojnë arsimtarëve/eve përmbajtjet e zhvillimit të qëndrueshëm. Tek arsimtarët/et është e domosdoshme të ngrihet vetëdija mbi vlerësimin e këtyre përmbajtjeve për secilën lëndë veç e veç. Trajnerët gjithashtu duhet të posedojnë edhe njohuri speciale për trajnimin e arsimtarëve/eve, të cilët do t'i realizojnë (ligjërojnë) përmbajtjet e lëndëve zgjedhëse të obligueshme.

Mësimi interaktiv nënkupton këmbimin (e përvojave, njohurive, bindjeve dhe nevojave në mes të udhëheqësit dhe pjesëmarrësve, si dhe ndërmjet pjesëmarrësve), lidhjen me përvojën dhe praktikën e vet (pikënisja nga përvojat dhe praktika, aplikimi dhe ndryshimi i praktikës), bashkëpunimin dhe partneritetin (mësimi kooperativ dhe raporti i bazuar në barazi, komplementaritet, kompetencë dhe respekt). Pikënisja themelore e këtij trajnimi është kategoria e *larmisë* në procesin e mësimin

Që të organizojë dhe realizojë një trajnim të tillë, trajneri duhet të posedojë njohuri dhe shkathtësi shtesë nga fusha e zhvillimit të qëndrueshëm, e për këtë është e domosdoshme që edhe ata/o vetë të kalojnë trajnimin gjegjës. Gjatë këtij trajnimi, trajnerët do t'i përforcojnë dhe kontrollojnë njohuritë dhe shkathtësitë që veç i posedojnë, do të fitojnë njohuri dhe shkathtësi të reja, veçanarisht ato që kanë të bëjnë me rëndësinë e arsimin për zhvillim të qëndrueshëm.

Reforma e sistemit të arsimit në Mal të Zi nënkupton që të gjithë nxënësit/et në shkollat fillore dhe të mesme të aftësohen për **lexim-shkrim informatik**, dhe se mbas trajnimit të arsimtarëve/eve kompjuterët të përdoren si një mjet themelor didaktik, si dhe të lidhen të gjitha të dhënat mbi mësimin dhe shkollimin. **Me strategjinë e futjes së teknologjive informatike në sistemin e arsimit** janë definuar të gjitha aktivitetet që e mundësojnë aplikimin e kompjuterit në mësim në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme.

Trajnimi ICT i arsimtarëve/eve është hallka më e rëndësishme në gjithë projektin, sepse procesi i përsosjes së arsimtarëve/eve është faktori vendimtar për përsosjen e mësimin.

Pasi që në të gjitha shkollat në Mal të Zi mësonjëtoreset e kompjuterëve janë të pajisura në mënyrë cilësore, me përdorimin e sistemit informativ, me futjen e **E**-mësimin në largësi me ndihmën e sistemit video-konferencial, mundësohet në tërësi sistemi i qëndrueshëm i trajnimit të arsimtarëve/eve dhe implementimi cilësor i Reformës së sistemit të arsimit.

Maturën e parë eksterne do ta japin në vitin 2010 maturantët/et e të gjitha gjimnazeve të Malit të Zi, të cilët/at janë regjistruar në klasën e parë në vitin 2006.

Ligji mbi shkollimin e fëmijëve me nevoja të posaçme është aprovuar në dhjetor të vitit 2004, dhe gjatë zbatimit të tij është shënuar rritje e dukshme e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të posaçme në shkolla të rregullta. Mirëpo problemi i trajnimit të pamjaftueshëm të arsimtarëve/eve për punë me fëmijë me nevoja të posaçme edhe më tutje mbetet shumë i shprehur.

Fusha e arsimimit inkluziv duhet të bëhet pjesë e programit për zhvillimin profesional të arsimtarëve/eve me qëllim që ata/ato të aftësohen për punë me ata fëmijë. Qëllimi tjetër jo më pak i rëndësishëm është ngritja e vetëdijes dhe njohurive mbi arsimimin e fëmijëve me nevoja të posaçme te drejtorët dhe profesionistët nga fusha e arsimit, që sa më mirë të reagojnë në krijimin e praktikës arsimore në lëmin e drejtimit, menaxhimit, administrimit dhe financimit. Qëllim shumë i rëndësishëm është aftësimi adekuat i shkollave dhe institucioneve të tjera me infrastrukturë të domosdoshme për fëmijët me nevoja të posaçme, futja në norma ligjore, punimi i programeve individuale si dhe aftësimi adekuat i arsimtarëve/eve për vlerësim (notim) të fëmijëve me nevoja të posaçme. Qendra e Provimeve do të përpilojë tekste të përshtatura për fëmijë me nevoja të posaçme, në përputhje me programin individual të trajnimit.

Zhvillimi dhe aplikimi i mjeteve mësimore është shumë i rëndësishëm për kuptimin, mësimin dhe përvetësimin e këtyre përmbajtjeve (tekstet, doracakët, revistat, kompjuterët, projektorët, video-shiritat, materiali propagandistik).

Teksti si mjet themelor mësimor dhe si pjesë e Reformës së tërësishme të arsimit, gjithsesi ka një rol shumë të rëndësishëm në realizimin e programit nga fusha e **zhvillimit të qëndrueshëm**. Padyshim se temat nga kjo fushë janë më shumë të përfshira në tekste, gjë që ka rezultuar me realizimin e një varg projektsh që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor dhe zhvillim të qëndrueshëm. Kjo i ka dhënë impuls shtues njohjes së fëmijëve me kultura të ndryshme, me kuptimin e ri të mjedisit jetësor, me sjellje më të kujdesshme ndaj tij, si dhe përvetësimin e kriteve dhe standardeve të reja.

Enti për Tekste dhe Mjete Arsimore – Podgoricë, nga dhjetori i vitit 2004, e boton revistën National Geographic Junior për Malin e Zi, dedikuar fëmijëve të cilët e ndjekin shkollën fillore, e që merren me tema nga biologjia, gjeografia, ekologjia, historia, arkeologjia, si dhe me aktivitete zbavitëse. Misioni të cilin e nxit revista është që fëmijët të njihen me kultura të ndryshme të botës, si dhe, në mënyrë interaktive, përmes zbavitjes, të fitojnë njohuri mbi botën bimore, shtazore, arkeologjinë, gjeografinë ...

Duke qenë se për realizimin e një detyre kaq komplekse është e domosdoshme përfshirja e aplikimit të gjerë shoqëror, është e nevojshme të bëhet një fushatë e mirë mediatike, ideimi i disa emisioneve shkencor-arsimore, të punohet sajti mbi zhvillimin e qëndrueshëm si dhe materiali propagandues (broshura, reklama...).

Projektet që i realizojnë organizatat joqeveritare janë shumë të rëndësishme për futjen e kësaj fushe në sistemin e arsimit.



## Plotësim 2. 2

### 2. 2 Bashkëpunimi me grupet e destinimit dhe informimi i opinionit

Meqenëse Strategjia e arsimit për zhvillim të qëndrueshëm inkuadron aspektet ekologjike, ekonomike dhe sociale të mjedisit jetësor, është e domosdoshme që të vendoset procedura të qarta mbi bashkëpunimin në mes ministrive kompetente.

Ngritja e vetëdijes dhe rritja e të kuptuarit në opinion mbi futjen e zhvillimit të qëndrueshëm në sistemin e arsimit në një masë të madhe varet nga paraqitja e kuptimtë mediatike dhe frymëzimi i opinionit profesional, nxënësve/eve dhe prindërve. Paraqitja e qëllimtë, e planifikuar dhe në kohë të duhur, imponohet si njëri nga kushtet kryesore të implementimit efikas të këtyre përbajtjeve. Për këtë është e domosdoshme të jetë i qartë koncepti i raportit ndaj mediave, të jenë të aftësuara resurset kadrovike për zbatimin e tij, dhe strategjia e verifikuar e realizimit të tij.

Udhëzimet për realizimin e mësimit, udhëzimet didaktiko-metodike, publikimet mbi rezultatet e hulumtimeve në arsim, sajti, përkthimi i revistave dhe publikimeve të huaja, duhet t'u ofrojnë pasqyrë të qartë dhe transparente të gjithë pjesëmarrësve në procesin e arsimit.

Gjithashtu është e domosdoshme që të definohen rregullat mbi bashkëpunimin me organizatat joqeveritare, shoqatat e ndryshme dhe organizata vullnetare. Kjo do të duhej të mundësojë realizimin e vazhdueshëm të projekteve të cilat i ofron sektori joqeveritar.

#### **Qëllimet kryesore deri në vitin 2009**

- „ Vendosja e procedurës mbi bashkëpunimin e grupit të punës ndërministrorë.
- „ Arritja e nivelit të kënaqshëm të informimit mbi zhvillimin e qëndrueshëm në të gjitha segmentet e shoqërisë.
- „ Realizimi i programeve të cilat i ofrojnë organizatat joqeveritare në mënyrë institucionale dhe sistematike.
- „ Aftësimi i kuadrove për fushatën mediatike.
- „ Realizimi i programeve me ndimën e shoqatave vullnetare.
- „ Njohja e opinionit (shkollat, nxënësit/et, prindërit, arsimtarët/et, dhe opinionit i gjerë) me nevojën e kontrollimit nacional (shtetëror) të njohurive dhe të testimit ekstern.

#### **Strategjije**

- „ Implementimi i Planit strategjik të Reformës së arsimit për periudhën e viteve 2005-2009.
- „ Implementimi i Strategjisë nacionale (shtetërore) të zhvillimit të qëndrueshëm të Malit të Zi.

#### **Treguesit e suksesit**

- „ Numri i projekteve të cilat i realizojnë dy ose më shumë ministri bashkarisht.
- „ Numri i publikimeve, revistave, broshurave, reklamave.
- „ Numri i projekteve të cilat i realizojnë organizatat joqeveritare.
- „ Numri i paraqitjeve mediatike.

#### **Supozimet dhe rreziqet**

- „ Pjesëmarrja aktive e ministrive të ndryshme.
- „ Përgatitja jo e mjaftueshme e mediave për këtë problematikë.
- „ Formimi i shoqatave vullnetare.

**Afatet dhe përcaktuesit – Bashkëpunimi me grupet e destinimit dhe informimi I opinionit**

<b>FAZAT/PËRCAKTUESIT</b>		<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>
1.	Vendosja e bashkëpunimit me ministrinë e dikastereve (hartimi i protokollit për bashkëpunim)			
2.	Ralizimi i projekteve të organizatave joqeveritare			
3.	Aftësimi i kuadrove për fushatë mediatike			
4.	Hartimi i revistave, publikimeve, broshurave, plakateve			
5.	Njohja e opinionit me ndryshimet në arsim			

**Buxheti – Bashkëpunimi me grupet destinimit dhe informimi i opinionit .**

<b>KOMPONENTA</b>	<b>SHPENZIMET NË EURA</b>			
	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>GJITHSEJ</b>
1. Vendosja e bashkëpunimit me ministrinë e dikastereve (hartimi i protokollit për bashkëpunim)	3500	2000	2000	<b>7500</b>
2. Ralizimi i projekteve të organizatave joqeveritare	5000	6000	7000	<b>18000</b>
3. Aftësimi i kuadrove për fushatë mediatike	5000	5000		<b>10000</b>
4. Hartimi i revistave, publikimeve, broshurave, plakateve	5000	5000	5000	<b>15000</b>
5. Njohja e opinionit me ndryshimet në arsim	1000	2000	2000	<b>5000</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>19500</b>	<b>20000</b>	<b>16000</b>	<b>55500</b>

## Plotësim 2. 3.

### 2. 3 Monitorimi dhe evaluimi i aplikimit të reformës

Vështrimi i karakteristikave dhe efekteve të realizimit të programeve të arsimit, si dhe akordimi i tyre me ndryshimet në arsim, ndikon drejtëpërdrejt në përmirësimin e procesit edukativo-arsimor.

#### **Qëllimet kryesore**

- „ Përparimi i procesit të implementimit të arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.
- „ Zhvillimi i metodologjisë për përcjellje të vazhdueshme dhe objektive të realizimit të programeve arsimore.

#### **Strategjia**

- „ Implementimi i Planit strategjik të reformës së arsimit për periudhën 2005 – 2009.
- „ Implementimi i strategjisë nacionale (shtetërore) të zhvillimit të mundshëm të Malit të Zi.

#### **Treguesi i suksesit**

- „ Gjatë mbikëqyrjes aplikohet sistemi i indikatorëve dhe deskriptorëve.
- „ Shkollat i përdorin informacionet mbi monitorimin në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes për periudhën e arsimit për zhvillim të mundshëm.

#### **Supozimet dhe rreziqet**

- „ Stërvitja e pamjaftueshme e edukatorëve.
- „ Kushtet materialo-teknike për futjen dhe zbatimin e Strategjisë nacionale (shtetërore) të zhvillimit të mundshëm të Malit të Zi.

#### **Afatet dhe përcaktuesit – Monitorimi dhe evaluimi i zbatimit të reformës**

<b>FAZAT/PËRCAKTUESIT</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>
<b>1. Evaluimi i programeve arsimore dhe arritjet</b>			
<b>2. Zhvillimi sistemit të indikatorëve</b>			
<b>3. Zhvillimi sistemit të deskriptorëve</b>			

#### **Buxheti – Monitorimi dhe evaluimi i zbatimit të reformës**

<b>KOMPONENTA</b>	<b>SHPENZIMET NË EURO</b>			
	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>GJITHSEJ</b>
<b>1. Evaluimi i programeve arsimore dhe arritjet</b>	8000	16526	16526	<b>41052</b>
<b>2. Zhvillimi sistemit të indikatorëve</b>	1000			<b>1000</b>
<b>3. Zhvillimi sistemit të deskriptorëve</b>	1000			<b>1000</b>
<b>GJITHSEJ</b>	10000	16526	16526	<b>43052</b>

## Plotësim 3.4

### 3.4 Përsosja profesionale dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Sistemi i vendosur i trajnimit me të cilin arsimtarët/et përgatiten në kohë të duhur për zbatimin e programeve të reja mësimore është e domosdoshme të zhvillohet më tutje. Përpos arsimtarëve/eve të cilët/at i zbatojnë programet e reja, duhet krijuar parakushte për zhvillim të vazhdueshëm profesional të arsimtarëve/eve, bashkëpunorëve/eve profesional/e, drejtorëve/eshave dhe ndihmësdrejtorëve/eshave, shkollat e të cilëve/ave ende nuk janë përfshirë në reformë.

#### ***Qëllimet kryesore deri në vitin 2009***

- " Zhvillimi i sistemit të qëndrueshëm të përsosjes së arsimtarëve/eve, drejtorëve/eshave dhe ndihmësdrejtorëve/eshave dhe bashkëpunorëve/eve profesional/e në Mal të Zi.
- " Të bëhet trajnimi i arsimtarëve/eve për realizimin e përmbajtjes së zhvillimit të qëndrueshëm.
- " Programi i trajnimit është i shpallur në katalogun e referencave të përparuara të arsimtarëve/eve.
- " Avancimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera të cilat arsimojnë mësimdhënës (fakultetet, organizatat e tjera).

#### ***Strategjia***

- " Implementimi i Planit strategjik të reformës së arsimit për periudhën 2005 – 2009.
- " Implementimi i Strategjisë së zhvillimit profesional të arsimtarëve/eve në Mal të Zi për periudhën 2005 - 2009.
- " Implementimi i strategjisë nacionale (shtetërore) të zhvillimit të mundshëm të Malit të Zi.

#### ***Treguesit e suksesit***

- " Trajnerët posedojnë njohuri dhe shkathtësi të cilat u janë të domosdoshme për futjen e zhvillimit të qëndrueshëm në sistem arsimor.
- " Programi i përpiluar i trajnimit u jep arsimtarëve/eve njohuri, shkathtësi dhe kompetenca të mjaftueshme.
- " Arsimtarët/et, pas mbarimit të trajnimit, i realizojnë me sukses përmbajtjet e zhvillimit të qëndrueshëm.
- " Arsimtarët/et përparojnë në profesion.

#### ***Supozimet dhe rreziqet***

- " Trajnimin e nevojshëm për të punuar sipas programit të ri arsimor nuk e kanë kaluar të gjithë/a arsimtarët/et dhe drejtorët/eshat e shkollave.
- " Bashkëpunimi i vendosur me institucionet e arsimimit inicial të arsimtarëve/eve në Mal të Zi dhe organizatat e tjera të cilat e realizojnë trajnimin e arsimtarëve/eve.

**Afatet dhe përcaktuesit – Përsosja profesionale dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional**

<b>FAZAT/PËRCAKTUESIT</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>
1. Zhvillimi i programit për trajnimin e arsimtarëve/eve			▲
2. Pilotimi i programit të trajnimit për arsimtarë/e			▲
3. Futja e përmbajtjeve të zhvillimit të qëndrueshëm në programin e trajnimit të drejtorëve/eshave			
4. Trajnimi i trajnerëve (në të gjitha nivelet e arsimit)			▲
5. Trajnimi i arsimtarëve/eve të institucioneve parashkollore			
6. Trajnimi i arsimtarëve/eve të shkollave fillore			
7. Trajnimi i arsimtarëve/eve të gjimnazeve			
8. Trajnimi i arsimtarëve/eve të shkollave të mesme profesionale			
9. Trajnimi i drejtorëve/eshave			
10. Trajnimi i notuesve, koordinatorëve, komisioneve të lëndëve dhe bashkëpunëtorëve/eve të angazhuar për nevoja të testimit nacional (shtetëror) dhe provimeve eksterne në shkollën fillore nga temat lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm të cilat gjenden në programet e lëndëve			▲

**Buxheti – Përsosja profesionale dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional**

KOMPONENTA	SHPENZIMET NË EURO			
	2007	2008	2009	GJITHSEJ
1. Zhvillimi i programit për trajnimin e arsimtarëve/eve	16333			16333
2. Pilotimi i programit të trajnimit për arsimtarë/e	4160			4160
3. Futja e përmbajtjeve të zhvillimit të qëndrueshëm në programin e trajnimit të drejtorëve/eshave	5000			5000
4. Trajnimi i trajnerëve (në të gjitha nivelet e arsimit)	22590			22590
5. Trajnimi i arsimtarëve/eve të institucioneve parashkollore		24500	24500	49000
6. Trajnimi i arsimtarëve/eve të shkollave fillore		31500	31500	63000
7. Trajnimi i arsimtarëve/eve të gjimnazeve		25000	25000	50000
8. Trajnimi i arsimtarëve/eve të shkollave të mesme profesionale		30000	30000	60000
9. Trajnimi i drejtorëve/eshave		10000	10000	20000
10. Trajnimi i notuesve, koordinatorëve, komisioneve të lëndëve dhe bashkëpunëtorëve/eve të angazhuar për nevoja të testimit nacional (shtetëror) dhe provimeve eksterne në shkollën fillore nga temat lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm të cilat gjenden në programet e lëndëve	20000	10000	10000	40000
<b>GJITHSEJ</b>	<b>68083</b>	<b>131000</b>	<b>131000</b>	<b>330083</b>

## Plotësim 3. 5.

### 3. 5 Integrimi i ICT-së në procesin arsimor

Pajisja e institucioneve shkollore, trajnimi ICT i arsimtarëve/eve dhe futja e programeve të reja të lëndëve janë aktivitete kyçe në realizimin e platformës, e cila do të kontribuojë që nxënësit/et gjatë shkollimit të **rregullt në shkollat fillore dhe të mesme** të arrijnë lexim-shkrimin e nevojshëm informatik. Me qëllim të zhvillimit të lexim-shkrimit informatik në përputhje me programet e reja arsimore, janë futur lëndë të reja të obligueshme (teknika dhe informatika për shkollim fillor dhe informatika për gjimnazin) dhe lëndët zgjedhëse, tri lëndë të reja për shkollën fillore dhe pesë lëndë të reja për gjimnazin dhe shkollat e mesme profesionale, (Informatika afariste, Web prezentimet kompjuterike, Algoritmi dhe programimi, Web programimi dhe baza e të dhënave, Sistemet kompjuterike dhe inxhinieringu).

Trajnimi ICT i arsimtarëve është hallka më e rëndësishme në mbarë projektin, sepse procesi i përsosjes së arsimtarëve/eve është faktori kyç për përsosjen e mësimi. Futja e mësimi në largësi përmes sistemit video-konferencial, e mundëson plotësisht qëndrueshmërinë e sistemit informatik në shkolla, një sistem të qëndrueshëm të trajnimit të arsimtarëve/eve dhe implementimin cilësor të reformës së sistemit të arsimit.

#### Qëllimet kryesore deri në vitin 2009

- „ Sigurimi i një sistemi të qëndrueshëm të trajnimit të arsimtarëve/eve e me këtë edhe implementimi cilësor i reformës së sistemit arsimor.

#### Strategjia

- „ Implementimi i Planit strategjik të Reformës së arsimit për periudhën e viteve 2005-2009.
- „ Implementimi i Strategjisë nacionale (shtetërore) të zhvillimit të qëndrueshëm të Malit të Zi.

#### Treguesi i suksesit

- „ Numri i arsimtarëve/eve të cilët e zbatojnë ICT-në gjatë realizimit të programeve të reja arsimore.

#### Supozimet dhe rreziqet

- „ Trajnimi i pamjaftueshëm i kuadrove të mësimdhënësve për shfrytëzimin e ICT-së.

#### Afatet dhe përcaktimet – Integrimi i ICT-së në procesin e arsimit

FAZAT/PËRCAKTUESIT	2007	2008	2009
1. Pajisja e lokacioneve qendrore			▲
2. Pajisja e mësonjëtove			
3. Trajnimi i arsimtarëve/eve për ICT			

#### Buxheti - Integrimi i ICT-së në procesin e arsimit

KOMPONENTA	SHPENZIMET NË EURO			
	2007	2008	2009	GJITHSEJ
1. Pajisja e lokacioneve qendrore	50000	50000		<b>100000</b>
2. Pajisja e mësonjëtove	100000	100000	100000	<b>300000</b>
3. Trajnimi i arsimtarëve/eve për ICT	10000	10000	10000	<b>30000</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>160000</b>	<b>160000</b>	<b>110000</b>	<b>430000</b>

## Plotësim 3.6.

### 3.6 Inkluzioni

Përmes reformës së arsimit në Mal të Zi është futur një koncept plotësisht i ri i arsimit inkluziv, i cili nënkupton integrimin dhe shkollimin e fëmijëve me nevoja të posaçme në shkolla të rregullta. Ky koncept bashkëkohor u mundëson „të gjithë fëmijëve mundësi të barabartë për arsimim“, që është një nga qëllimet themelore të arsimit. Për qëllim të realizimit të konceptit të arsimit inkluziv është miratuar ligji mbi edukimin dhe arsimimin e fëmijëve me nevoja të posaçme, janë formuar ekipe mobile, aktivitetet e të cilave është e domosdoshme të mbështeten në periudhën e ardhshme. Në periudhën e ardhshme të implementimit, përmes fushatës mediatike, inkuadrimin të prindërve dhe trajnimit të arsimtarëve/eve, është e nevojshme që theks i veçantë t'i jepet përkrahjes së implementimit të arsimit inkluziv, ashtu që edhe nxënësit/et të cilët/at përballen me pengesa në mësim, të mund të kenë dobi përmes qasjeve të individualizuara dhe metodave të mësimin, të cilat janë të orientuara kah nxënësi/ja. Poashtu janë të rëndësishme tri komponente vijuese: zhvillimi i politikës në fushën e arsimit të fëmijëve me nevoja të posaçme dhe arsimimit inkluziv, përkrahja e fakultetit Filozofik në lëminë e arsimit të nxënësve/eve me nevoja të posaçme dhe arsimit inkluziv dhe përkrahja e MADheSH dhe Entit për Shkolim në zhvillimin e trajnimit të arsimtarëve/eve të inkuadruar/a në punë, në fushën e arsimit të këtyre fëmijëve. Gjithashtu, është krijuar baza e të dhënave e cila e përcjell arsimimin e fëmijëve me nevoja të posaçme dhe inkuadrimin e mëtejshëm të tyre në shoqëri.

Ligji mbi shkollimin e fëmijëve me nevoja të posaçme është miratuar në dhjetor të vitit 2004 dhe gjatë implementimit të tij është shënuar rritje e dukshme e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të posaçme në shkolla të rregullta. Mirëpo problemi i trajnimit të pamjaftueshëm të arsimtarëve/eve për punë me fëmijë me nevoja të posaçme mbetet mjaft i theksuar. Ky projekt do të sigurojë trajnimin e ekipeve profesionale të shkollave për arsimim inkluziv në 40 shkolla. Ekipet do të përbëhen nga dy arsimtarë/e, psikologu i shkollës, pedagogu, drejtori/esha dhe ndihmësdrejtori/esha e shkollës (gjithsej 240 persona), si dhe trajnimin e referentave komunale për arsim në secilën nga 21 komunat në Mal të Zi.

#### ***Qëllimet kryesore deri në vitin 2009***

- „ Lëmi i arsimit të fëmijëve me nevoja të posaçme dhe i arsimit inkluziv duhet të bëhet pjesë e programit për zhvillimin profesional të arsimtarëve/eve që ata të aftësohen për punë me këta fëmijë.
- „ Ngritja e vetëdijes dhe njohurive mbi arsimimin e fëmijëve me nevoja të posaçme ndër drejtorët/eshat dhe profesionistët nga fusha e arsimit, që sa më mirë të reagojnë në krijimin e praktikës arsimore në fushën e udhëheqjes, menaxhimit, administrimit dhe finansimit.
- „ Kushtet adekuate për testimin e nxënësve/eve me nevoja të posaçme duke përfshirë edhe testet e përshtatura.

#### ***Strategjia***

- „ Implementimi i Planit strategjik të Reformës së arsimit për periudhën e viteve 2005-2009.
- „ Implementimi i Strategjisë nacionale (shtetërore) të zhvillimit të qëndrueshëm të Malit të Zi.

#### ***Treguesit e suksesit***

- „ 40 shkolla fillore inkluzive me të cilat udhëhiqet mirë, të cilat do të mund t'i ofrojnë përkrahje kompetente procesit të mësimin të të gjithë nxënësve/eve, duke përfshirë edhe nxënësit/et me nevoja të posaçme arsimore.
- „ Nxënësit/et me nevoja të posaçme të testuar/a në përputhje me standardet nga programi individual i trajnimit.

#### ***Supozimet dhe rreziqet***

- „ Nuk janë të trajnuar mirë të gjithë arsimtarë/et dhe drejtorët/eshat që të punojnë sipas programit të ri arsimor.
- „ Bashkëpunimi i pamjaftueshëm ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë për Punë dhe Kujdesje Sociale.



## Afatet dhe përcaktuesit - Inkluzioni

FAZAT/PËRCAKTUESIT	2007	2008	2009
1. Trajnimi i ekipeve profesionale të shkollave			
2. Trajnimi i referentëve komunalë			
3. Trajnimi i hartuesve të testeve			▲
4. Punimi i testeve individuale			▲

## Buxheti – Inkluzioni

KOMPONENTA	SHPENZIMET NË EURO			
	2007	2008	2009	GJITHSEJ
1. Trajnimi i ekipeve profesionale të shkollave	370000	192000	192000	<b>754000</b>
2. Trajnimi i referentëve komunalë	16800	16800		<b>33600</b>
3. Trajnimi i hartuesve të testeve	30000	30000	30000	<b>90000</b>
4. Punimi i testeve individuale	50000	50000	50000	<b>150000</b>
<b>GJITHSEJ</b>	466800	288800	272000	<b>1027600</b>

## Plotësim 3.7

### 3.7 Arsimimi i pakicave

Një nga qëllimet e rëndësishme dhe pikënisëse të Reformës të arsimit në Mal të Zi është ndërtimi i shoqërisë civile dhe sigurimi i kushteve të barabarta dhe mundësia e arsimit për të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh gjininë, **gjuhën amtare**, prejardhjen sociale dhe kulturore, konfesionin dhe përkatësinë nacionale. Sistemi i reformuar i arsimit dhe programet e reja mësimore të gjuhës amtare, historisë, kulturës muzikore dhe figurative, e promovojnë multikulturalizmin dhe kohezionin shoqëror. Programet e reja arsimore janë të orientuara që t'i përgatisin të rinjtë për jetë civile në Evropën multikulturore.

Cilësi e posaçme dhe risi e rëndësishme në programet e reja arsimore, të rëndësishme për afirmimin e identitetit nacional dhe kulturor, është koncepti i ri i cili e afirmon »integrimin pa asimilim«. Esenca e konceptit të miratuar është që populli shumicë në tërë territorin e Republikës të mësojë në mënyrë afirmative mbi vlerat letrare, historike dhe kulturën e popujve pakicë. Programet e reja, të miratuara, të gjuhës amtare, historisë dhe kulturës, janë të punuara si programe të përbashkëta, të cilat, në masë të mjaftueshme, përmbajnë dhe promovojnë tema, krijues, vlera letrare dhe figurative, historinë dhe kulturën e të gjithë popujve në Mal të Zi.

Nga aspekti i dallimeve gjuhësore, në kuptimin e përdorimit të gjuhës amtare në Mal të Zi dallohen dy popuj pakicë – shqiptarët dhe romët.

#### 3.7.1. Arsimimi në gjuhën amtare shqipe

Populli shqiptar në Mal të Zi përbën një pakicë të konsiderueshme, autoktone. Sipas regjistrimit të popullatës, të vitit 2003, në Mal të Zi jetojnë 7,09% pjesëtarë të nacionalitetit shqiptar. Në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin, mësimi në gjuhën amtare shqipe në sistemin arsimor të Malit të Zi është i organizuar në të gjitha nivelet e arsimit.

Për implementimin e **suksesshëm** të programeve të reja arsimore në **gjuhën shqipe** është e domosdoshme të sigurohet:

- Përkthimi dhe botimi i programeve të reja arsimore në gjuhën shqipe.
- Përkthimi dhe botimi i teksteve të reja në gjuhën shqipe.

#### **Qëllimet kryesore deri në vitin 2009**

- „ Sigurimi i një sistemi të qëndrueshëm të trajnimit të arsimtarëve/eve, e me këtë edhe implementimi cilësor i Reformës së sistemit arsimor.
- „ Sigurimi i përkthimit në gjuhën shqipe të programeve të reja arsimore të miratuara.
- „ Sigurimi i përkthimit të teksteve në gjuhën shqipe për programet e reja arsimore.

#### **Strategjia**

